



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 11

Datë: 11. 05. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dhe Financa

- *shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës;*

Këshilli për Operacione Zgjedhore

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme, për Kuvendin e Kosovës;*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës;*
- *Themelimi i Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës;*
 - **Këshilli për Çështje Ligjore**
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendi Komunal në Partesh;*

3. Të ndryshme

1. Hyrje

Mbledhja, është kryesuar nga Valdete Daka, kyetare e KQZ

Valdete Daka: Përshëndetje. Duke u bazur në dekretin e Presidentit të vendit, i cili dekret pak çaste më parë ka ardhur në zyrat tona, zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të mbahen më 11 qershor, 2017.

KQZ, i ka filluar menjëherë përgatitjet e parapara sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. I ftoj anëtarët e KQZ-së që, të deklarohen lidhur me agjendën e këtyre zgjedhjeve.

Betim Gjoshi: Fillimisht, ua uroj anëtarëve të KQZ-së dhe gjithë qytetarëve këto zgjedhje, dhe kam një kërkesë (se di nëse ka nevojë të futet si pikë e reddit të ditës...) që ne si KQZ, ti ftojmë qysh sot vëzhguesit ndërkombëtar të BE-së, të ENEM-os, të ACEEO-së, të OSBE-së dhe organizatave të tjera që ta bëjmë sa më kredibil, këtë proces zgjedhor. Unë e di, tha z. Gjoshi se, këtë ftesë e bënë edhe presidenti, por ne qysh sot t'i ftojmë këta mekanizma...

Bajram Ljatifi: Në të ndryshme, është mirë që ne të kërkojmë nga Kryeshefi që në çdo mbledhje të KQZ-së, të na sillt një raport për secilën ditë lidhur me punët dhe aktivitetet që zhvillohen në sekretariat.

Valdete Daka: E kemi rendin e ditës me një propozim shtesë për ftesën për vëzhgim të zgjedhjeve! Kush është për këtë rend dite ?

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

Ilir Gashi: Ju përshëndesë dhe gjithashtu, edhe unë uroj që të kemi zgjedhje të mira ashtu siç e kërkon një proces zgjedhor...Ne, si këshill jemi takuar sot menjëherë, dhe kemi shqyrtuar buxhetin e nevojshëm që duhet ta ketë procesi zgjedhor, natyrishtë duke u bazuar edhe në ligj, më konkretisht në nenin 66. 8 të tij...si këshill buxhetin e kemi aprovuar në vlerë prej: 4 milion e 944 900 euro. Shuma e planifikuar e mjeteve buxhetore, kryesishtë ka të bëjë me prodhimin e materialeve zgjedhore, transporteve, të materialeve sensitive, josensitive, trajnimin e Këshillave të Vendotimeve, pagesat e anëtarëve të këshillave, e kështu me radhë... Para vete, e keni buxhetin i cili ka ardhë nga këshilli, dhe ne e kemi miratuar, dhe unë kërkoj që edhe nga ju të miratohet. Ju falemiderit! Për më shumë detaje tjera, ndoshta fletë kryeshefi ose drejtoresha.

Betim Gjoshi: E kam një pyetje: E para, kërkesa duhet t'i drejtohet edhe sekretarit të Qeverisë sepse, kemi pasur problem kur nuk iu ka drejtuar atij, dhe e dyta: a, do të ketë edhe ndonjë specifikë kjo kërkesë...? A do të jetë një plan më i detajuar...?

Enis Halimi: Plani, ashtu siç kërkon rregullativa financiare, do të përshtatet sipas rregullativës në fuqi dhe do të procedohet në Ministrinë e Financave, dhe rregullativat e tjera dhe, çdo gjë do të procedohet sipas specifikave të caktuara.

Bajram Ljatifi: A është çdo gjë e garantuar...?

Enis Halimi: Plani ka rrjedhë nga poshtë - lartë, dhe si i këtillë, i përfshinë kërkesat e njësive në funksion të realizimit të një procesi zgjedhor.

Adnan Rrustemi: Faliminderit. Kshilli i operacioneve zgjedhore, kohët e fundit dhe ditën e sotme, ka shqyrtuar disa nga dokumentet dhe procesin e organizimit e zgjedhjeve të jashtzakonshme që do të mbahen më 11 qershor. Ky plan, parasheh ndërmarrjen e masave nga KQZ lidhur me prëgaditjen e procesit zgjedhor, si: përpilimin dhe certifikimin e listes së votuesve, afatin për nominimin e komisioneve, të këshillave për certifikimin e listes së votuesve, e deri tek aktivitet tjera: akreditimin e vëzhguesve, të mediave. Afati për i fundit për aplikim për certifikim të subjekteve politike, është 18 maji. Periudha e certifikimit të listës së votuesve, është 1 qeshori. Këshilli, ka rekomandue që fushata parazgjedhore të zgjatet prej 10 ditë...

Këshilli, rekomandon që KQZ ta miratoj këtë plan...Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KQZ-it.

(Për arsye teknike dhe paqartësisë se stenogramit, nuk ka qenë e mundur zbardhja e mëtejme e procesverbalit...)